



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROÇEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / 09/ 2016

Lënda : Dërgohen mendime dhe sugjerime për projektligjin “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Drejtuar : **Znj. Albana VOKSHI**
Kryetare
Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë
KUVENDI

TIRANË

E nderuar zonja Kryetare!

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi u njoh me projektligjin “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, dëshiron të sjellë në vëmendjen e këtij Komisioni këto mendime dhe sugjerime si më poshtë:

Së pari: Sugjerojmë që pika 11, e nenit 3 ku jepet përkufizimi i termit “*Person me aftësi të kufizuar*” të referojë tek përkufizimi që i bëhet këtij termi sipas ligjit Nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

Së dyti: Në gërmën “ë”, të nenit 4, ku jepet parimi i ndalimit të diskriminimit, sugjerojmë që të riformulohet sipas përkufizimit që bën ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pasi format e shfaqjes së diskriminimit nuk janë vetëm diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë dhe shkaqet e diskriminimit nuk janë vetëm ato që citohen në këtë pikë. Në të njëjtën llogjikë edhe përkufizimi që i behet termit “*diskriminim*” në pikën 20 të nenit 3, të projektligjit, referon tek ligji i posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERE

Irma BARAKU



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al